



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Komuna e Fushë Kosovës, përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.857, më datë: 04.06.2026, shpall Thirrjen Publike për përkrahjen financiare të start-up bizneseve inovative dhe bizneseve të reja në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

THIRJE PUBLIKE

Për përkrahjen financiare të start-up bizneseve inovative dhe bizneseve të reja në Komunën e Fushë Kosovës për vitin 2026

Buxheti i planifikuar për këtë thirrje është: 130,000.00€, ku përfitues do të jenë 30 - 40 start-up biznese. Inkurajohen veçanërisht aplikimet nga të rinjtë, gratë ndërmarrëse, dhe aplikuesit që kanë ide biznesi me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- formularin e aplikimit;
- planin e biznesit;
- buxhetin e propozuar;
- kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit;
- dëshminë e vendbanimit në Komunën e Fushë Kosovës;
- vërtetimin se nuk ka obligime të papaguara ndaj Komunës, ose dëshminë për marrëveshje aktive të pagesës me këste;
- deklaratën nën betim se nuk ka përfituar financim publik për të njëjtat shpenzime;
- ofertat ose pro-faturat për shpenzimet e planifikuara;
- dokumente të tjera mbështetëse që lidhen me natyrën e idesë së biznesit.

Certifikata e biznesit nga ARBK kërkohet vetëm nga aplikuesit që shpallen fitues, pas publikimit të listës përfundimtare dhe para nënshkrimit të kontratës së grantit me Komunën.

Fushat prioritare të përkrahjes

Thirrja është e hapur për fusha të ndryshme ekonomike, me përparësi për:

- teknologji informative, digjitalizim dhe shërbime online;
- zgjidhje softuerike dhe automatizim;
- prodhim dhe përpunim të vogël lokal;
- agrobiznes urban dhe përpunim ushqimor në shkallë të vogël;
- ekonomi të gjelbër, riciklim, ripërdorim dhe eficiencë energjetike;

- shërbime profesionale dhe zejtari moderne;
- industri kreative, dizajn, artizanate, brendim dhe produkte kulturore;
- shërbime për fëmijë, të rinj, familje dhe komunitet;
- turizëm lokal dhe promovim të potencialeve lokale;
- veprimtari të tjera të ligjshme që krijojnë vlerë të shtuar, vetëpunësim ose punësim lokal.

Afati për aplikim fillon nga data 08.06.2026 deri më 28.06.2026.

Aplikacionet dorëzohen fizikisht në zyrën pritëse në objektin e Komunës së Fushë Kosovës, në adresën: Rr. "Tahir Zemaj", 12000, Fushë Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit ose aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret administrative nuk do të merren në shqyrtim.

Për informata shtesë, aplikuesit mund të kontaktojnë Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë në Komunën e Fushë Kosovës përmes e-mailit: pranvera.merovci@rks-gov.net, numrit të telefonit

038-200-40524 ose drejtpërdrejtë në objektin e Komunës së Fushë Kosovës.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik

